# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6841
E hënë, 6 mars 2023
çmimi 0.40


## Gazeta "Daily Observer" boton një recension për librin e Sabri Kiçmarit "Historia vazhdon"

FAQE 8


Weekend Observer
Book Reviews
History Continues
Sabri Kiçmari
A kosovan diplomat describes 3 extreme models threatening world peace and democracy...


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MIJËRA QYTETARË NGA KOSOVA, SHQIPËRIA, LUGINA DHE MAQEDONIA E VERIUT I DHANË LAMTUMIRËN E FUNDIT ISH-EPRORIT TË LARTË TË UÇK-së, AGRON HARADINAJT FAQE 3-4-5

# LAMTUMIRË AGRON HARADINAJ! DO TË JESH GJITHMONË NË KUJTESËN E POPULLIT SHQIPTAR



Në varrezat e Kompleksit Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan të Deçanit me nderime të larta ushtarake, në mesin e mijëra qytetarëve nga Kosova, Shqipëria, Lugina dhe Maqedonia e Veriut, të dileën i është dhënë lamtumira e fundit, veteranit të luftës dhe ish-eprorit të UÇK-së, Agron Haradinajt, djalit të veprimtarit të çështjes kombëtare, Smajl Haradinajt dhe vëllait të ish-nënkryetarit të OVLUÇK-së, Nasim Haradinajt. Në fjalimet që mbajtën bashkëluftëtarët dhe bashkëveprimtarët e tij, theksuan se emri dhe vepra atdhetare e Agronit do të mbesin gjithmonë në kujtesën e popullit shqiptar





# KOSOVA SHËNON 25-VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-së

FAQE 5



## AKTUALE



### UKRAINA PRETENDON SE I KA SHKAKTUAR HUMBJE TË MËDHA USHTRISË RUSE F. 2

### KRYEMINISTRI GREK KËRKON FALJE PËR AKSIDENTIN ME TRENA F. 2

## EKONOMI



### KEK-u ENDE S'I KA PAGUAR PUNËTORËT PËR PUNËN NË FUNDJAVË F. 8

### REZERVA FEDERALE PARALAJMËRON RRITJE TË NORMAVE TË INTERESIT PËR TA LUFTUAR INFLACIONIN F. 8



## SPORT



### BALLKANI NDAN PIKËT ME PRISHTINËN F. 14


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Kryeministri grek kërkon falje për aksidentin me trena

Athinë, 5 mars - Kryeministri grek më 5 mars ka kërkuar falje nga familjet e 57 viktimave në tragjedinë më të rëndë me trena në këtë shtet, teksa mijëra protestues u mblodhën në Athinë dhe u përleshën me policinë.
"Si kryeministër u kam borxh të gjithëve, veçmas familjarëve të viktimave, që t'u kërkoj falje", tha kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis. "Për Greqinë e vitit 2023, dy trena që udhëtojnë në drejtime të ndryshme nuk mund të lëvizin në shinë të njëjtë dhe askush të mos e vërejë", shkroi ai në "Facebook".
Përplasja e një treni të pasagjerëve dhe një të mallrave afër qytetit të Larisës të martën ka nxitur zemërim në mbarë Greqinë.
Mijëra protestues të zemëruar u mblodhën para Parlamentit në Athinë të dielën, pas thirrjes së studentëve, punëtorëve të hekurudhave dhe punëtorëve të sektorit privat.
Gjatë protestës pati përleshje midis policisë dhe protestuesve. Protestuesit lëshuan në qiell qindra balona të zinj në kujtim të viktimave dhe disa mbanin mbishkrime: "Mjaft me qeveritë vrastare!".
Pas tragjedisë, shërbimet e trenave dhe metrove janë paralizuar nga grevat.
Më 4 mars Shqipëria ka konfirmuar se katër shtetas shqiptarë ose me origjinë shqiptare janë në mesin e viktimave të përplasjes së trenave në Larisa. Të dielën, më 5 mars, në Shqipëri është ditë zie në nderim të viktimave shqiptare në aksidentin në Greqi.
Për shkak të aksidentit, ministri grek i Transportit ka dhënë dorëheqje.



# Ukraina pretendon se i ka shkaktuar humbje të mëdha ushtrisë ruse



Kiev, 5 mars - Ushtria ukrainase tha më 5 mars se ka zmbrapsur mbi 130 sulme të armikut në 24 orët e fundit dhe pretendoi se ka shkaktuar viktima të shumta në palën ruse. Megjithatë, ajo nuk dha asnjë tregues lidhur me fatin e qytetit lindor të Bahmutit, të cilin forcat ruse kanë thënë se e kanë rrethuar pothuajse krejtësisht.
Kievi ka kërkuar që të vë në pah numrin e lartë të viktimave që ka shkaktuar në palën ruse në mes të ofensivave dërrmuese, duke përfshirë edhe përpjekjet e vazhdueshme të Moskës për të rrethuar dhe marrë kontrollin e Bahmutit, që gjendet në rajonin lindor ukrainas të Donjeckut.
Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka tentuar të vë në pah përgatitjet e Kievit dhe mbështetjen e Perëndimit për një anëtarësim të shpejtë në Bashkimin Evropian, si një aspekt tjetër i mbështetjes së vazhdueshme ndërkombëtare për ukrainasit që po mbrojnë vendin e tyre nga pushtimi i paprovokuar rus që nisi një vit më parë.
Pas takimit me presidenten e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, presidenti ukrainas tha se "detyra është që të përgatitim çdo gjë për pranimin e shtetit tonë në BE, t'i rrisim dërgesat me armë në Ukrainë, t'i forcojmë sanksionet kundër Rusisë".
Në raportimin ditor më 5 mars, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase tha se Rusia po vazhdon ofensivat në drejtim të Bahmutit, Avdijivkës, Limait dhe Shahtarit në Donjeck, por edhe në Kupjan në rajonin e Harkivit.
Ushtria ukrainase, po ashtu, tha se në 24 orët e fundit ka vrarë 930 trupa ruse.
Të dyja palët nuk zbulojnë numrin e ushtarëve të tyre të vrarë dhe "Radio Evropa e Lirë" e ka të pamundur t'i verifikojë pretendimet e palëve.
Serhiy Cherevaty, zëdhënës i Forcave të Grupit Lindor të Ukrainës, i tha CNN-it më 4 mars se ushtarët ende kanë nën kontroll Bahmutin. "Po ashtu, nuk ka tërheqje masive të trupave ukrainase", tha ai.
Vetëm një rrugë nga Bahmuti thuhet se është e hapur, dhe kreu i grupit rus të mercenarëve, Wagner, Yevgeny Prigozhin, tha se edhe ajo do të mbyllet, me raportimet që sugjerojnë se mijëra banorë që vazhdojnë të jenë në qytet, do të detyrohen të largohen.
Kievi e ka pranuar se situata rreth Bahmutit është e rëndë, por ka shtuar se ende ka trupa atje, teksa ekspertët ushtarakë perëndimorë kanë argumentuar se situata në këtë qytet është e rëndë.
Për ekspertët perëndimorë Bahmuti ka më pak vlerë strategjike sesa simbolike për Kremlinin. Sipas ushtrisë ukrainase, Rusia ka humbur mbi 153 000 ushtarë që nga nisja e pushtimit në shkurt të vitit 2022.
Zyrtarët amerikanë dhe perëndimorë së fundmi kanë vlerësuar se numri i viktimave në palën ruse - përfshirë të vrarë dhe të plagosur - po i afrohet shifrës prej 200 000.
Moska ka pranuar se ka pësuar humbje "të mëdha" dhe në shtatorin e kaluar ka raportuar për nën 6 000 viktima.

# Turqia thotë se po punon për zgjatjen e marrëveshjes për drithërat

Ankara, 5 mars - Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, tha se Ankaraja po punon shumë për ta zgjatur nismën e mbështetur nga OKB-ja që i ka mundësuar Ukrainës të eksportojë drithëra nga portet e bllokuara nga Rusia pas nisjes së pushtimit.
Nisma për drithërat në Detin e Zi, e ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dhe Turqia korrikun e kaluar, lejon eksportet nga tri porte ukrainase.
Marrëveshja u zgjat deri në nëntorin e vitit të kaluar, por skadon më 18 mars, nëse palët nuk arrijnë pajtim për zgjatjen e saj. "Ne po punojmë fort për zbatimin dhe zgjatjen e mëtejme të marrëveshjes për drithërat në Detin e Zi", tha Cavugoslu gjatë konferencës për shtetet e zhvilluara të OKB-së, që po mbahet në Doha të Katarit.
Po ashtu, kryediplomati i Turqisë tha se për zgjatjen e kësaj marrëveshjeje do të diskutojë edhe me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres.
Më herët gjatë kësaj jave, Rusia tha se do të pajtohej për ta zgjatur marrëveshjen për drithërat vetëm nëse interesat e saj për prodhimet e agrikulturës merren në konsideratë.
Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022 dhe ka bllokuar portet në Detin e Zi, që janë vitale për eksportet e drithërave. Rusia dhe Ukraina janë ndër prodhueset më të mëdha në botë të drithërave.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

MIJËRA QYTETARË NGA KOSOVA, SHQIPËRIA, LUGINA DHE MAQEDONIA E VERIUT I DHANË LAMTUMIRËN E FUNDIT ISH-EPRORIT TË LARTË TË UÇK-SË, AGRON HARADINAJT

# Lamtumirë Agron Haradinaj! Do të jesh gjithmonë në kujtesën e popullit shqiptar



Në varrezat e Kompleksit Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan të Deçanit me nderime të larta ushtarake, në mesin e mijëra qytetarëve nga Kosova, Shqipëria, Lugina dhe Maqedonia e Veriut, të dielën i është dhënë lamtumira e fundit veteranit të luftës dhe ish-eprorit të UÇK-së, Agron Haradinajt, djalit të veprimtarit të çështjes kombëtare, Smajl Haradinajt dhe vëllait të ish-nënkryetarit të OVLUÇK-së, Nasim Haradinajt. Në fjalimet që mbajtën bashkëluftëtarët dhe bashkëveprimtarët e tij, theksuan se emri dhe vepra atdhetare e Agronit do të mbesin gjithmonë në kujtesën e popullit shqiptar

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Deçan/Gllogjan, 5 mars** - Në varrezat e Kompleksit Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan të Deçanit me nderime të larta ushtarake të dielën i është dhënë lamtumira e fundit ish-eprorit të lartë të UÇK-së, Agron Haradinajt, djalit të veprimtarit të çështjes kombëtare, Smajl Haradinajt dhe vëllait të ish-nënkryetarit të OVLUÇK-së, Nasim Haradinajt.

Mijëra qytetarë nga gjithë Kosova, Shqipëria, Lugina dhe Maqedonia e Veriut kishin ardhur për t'i dhënë lamtumirën e fundit në Gllogjan, Agronit. Në ceremoninë e varrimit të Agronit kanë marrë pjesë edhe personalitete të shumta nga jeta publike e politike në vend. Por në këtë ceremoni të varrimit mungoi i vëllai, Nasim Haradinaj, i cili po vuan dënimin prej mbi katër vjetësh nga Gjykata Speciale në Hagë, e cila pamundësoi pjesëmarrjen e tij në varrimin e vëllait. Është tepër e vështirë për Nasimin pamundësia për të hedhur një grusht dhe mbi varrin e tij.

Agroni ishte i njohur si i burgosuri politik më i ri në ish-shtetin okupator. Pa mbushur 17 vjet ai u angazhua në rrugën e lirisë, rrugën e babait të tij, Smajlit dhe më vonë vëllezërve, Nasimit e Naimit, si pjesëtar i UÇK-së.

### Agroni tërë jetën e kishte në shërbim të atdheut

Ish-kryeministri dhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se sot po përcjellin për në banesën e fundit djalin e patriotit të shquar Ismajl Haradinajt, Agronin. "Agroni ishte një luftëtar mjaft i zoti. Ata që kanë qenë në luftë me Agronin e dinë se në luftimet më të ashpra dhe më të vështira ai ka qenë me ta. Ka shkuar i pari dhe është larguar i fundit. Kështu ka qenë baca Smajl në qëndresën e tij nëpër burgje, dhe kjo ka vazhduar me secilin anëtarë të kësaj familjeje. Agroni këtë qëndresë e ka transmetuar në luftë dhe ka qenë një prej komandantëve që

→







ka aftësuar ushtarë të zot. I përjetshëm kujtimi për Agronin", ka thënë Haradinaj në fjalimin e tij.

Ndërkaq kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka theksuar se në errësirë ku nuk shihej dritë, kishte burra e gra që e mbajtën shpresën gjallë për të pasur rreze dielli mbi këtë vend. "Përfaqësuesi më tipik i kësaj shprese ishte Ismajl Haradinaj dhe bashkudhëtarët e tij. Sot nderuam Agronin e bacës Smajl, i burgosur si 16-vjeçar. Sot kujtuam e nderuam Agronin, pjesëtarin e familjes më të persekutuar shqiptare. Sot i dhamë lamtumirën e fundit Agronit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot Agronit i thamë lamtumirë edhe në emër të Nasimit, i cili ende vazhdon të jetë në burg. Qoftë i paharruar kujtimi për ty! Lavdi!", ka theksuar Ramosaj.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se e kanë përjetuar rëndë ndarjen nga shoku dhe bashkëluftëtari i tyre Agron Haradinaj. "Kjo është humbje e madhe jo vetëm për familjen, por për të gjithë ne, sepse ai nuk i kishte takuar asnjëherë vetëm familjes, sepse fatin e vet e kishte ndarë me familjen e madhe, popullin. Agroni tërë jetën e kishte në shërbim të atdheut dhe nuk ka se si mos të jetë kështu, sepse angazhimin për vendin e tij së bashku me Nasimin e kishte trashëguar nga babai, Smajli. Para luftës ish i burgosur politik, gjatë luftës së UÇK-së ndër luftëtarët më të zotë të saj dhe pas luftës kontribuues i madh i shtetndërtimit", ka theksuar Klinaku.



## Eprori Agron Haradinaj u shqua si një ndër luftëtarët më të zotë të UÇK-së

Ish-luftëtari i UÇK-së, Faton Mehmetaj, ka folur për veprimtarinë e Agronit. Ai ka ngushëlluar Nasim Haradinajn për humbjen e vëllait. "Ngushëllime Nasim për humbjen e vëllait të cilin e pate bashkëveprimtar dhe bashkëluftëtar që rrugëtuat tërë jetën drejt shtigjeve të lirisë", ka thënë Mehmetaj.

Ai ka thënë se Agroni ishte një burrë i madh dhe veprimtaria e tij është e pavdekshme. "Atdhedashuria, ndenja më e lartë sublime, identifikohet me emrin e tij. Sot Agroni pushon në banesën e tij të fundit, por nderimi dhe kujtimi për të do të jetojnë gjatë në kujtesën tonë kolektive dhe historike. Agron Haradinaj lindi më 17 korrik të vitit 1966 në Gllogjan, në familjen e madhe të kombit shqiptar Haradinaj që dha shumë për lirinë e popullit shqiptar brez pas brezi. Agroni shkollën fillore e kreu në Gramaqel, kurse shkollën e mesme bujqësore në Pejë, sepse ishte larguar në atë kohë nga procesi mësimor në Deçan si kundërshtar politik i regjimit. Emri i Agronit është i lidhur thellësisht me Kosovën, me historinë e saj, me luftën heroike të brezave që punuan dhe sakrifikuan për liri. Agroni e bëri një jetë me plotë krajata, sepse ishte djali i Smajl Haradinajt, kryeheroit të brezit të vitit 1981, i veprimtarit të hershëm të çështjes kombëtare", ka theksuar ai.

Mehmetaj ka treguar se Agroni ishte i angazhuar edhe në demonstrata dhe aktivitete të tjera kundër Jugosllavisë. "Pos këtyre aktiviteteve, Agroni me vëllezërit e tij Naimin dhe Nasimin dhe shokët e tjerë të idealit ishin të inkuadruar në celulat e para të UÇK-së, duke kryer një punë të madhe në organizimin e luftës në Kosovë. Me të filluar lufta në Kosovë, Nasimi e Agroni së bashku me shokë të tjerë iu bashkuan UÇK-së duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në çlirimin e vendit", është shprehur ai, duke shtuar se eprori Agron Haradinaj u shqua si njëri ndër luftëtarët me të zotë të UÇK-së. "Një jetë të tërë ishte në shërbim të atdheut. Para lufte, në luftë dhe në paqe. Duke u bërë pjesëmarrës dhe organizator në çlirimin e Kosovës, duke qenë organizator dhe pjesëmarrës edhe i luftës së UÇPMB-së në Kosovën Lindore dhe i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni dhe në ndërtimin e shtetit të Kosovës", ka thënë Mehmetaj.

Ai ka thënë se vuajtjet dhe sakrificat e familjes Haradinaj për ta fituar lirinë dhe për ta ndërtuar shtetin ishin të mëdha. "Qëndresa dhe lavdia e kësaj familjeje ishte dhe do të









mbetet e pasosur. Burgosja e Ramush Haradinajt nga Gjykata e Hagës dhe Daut Haradinajt nga Gjykata e UNMIK-ut, të ndikuara kryekëput nga Serbia dhe tash së fundi burgosja e Nasim Haradinajt nga Gjykata Speciale dhe e krerëve të tjerë të UÇK-së, shënon padrejtësitë më të mëdha që iu bënë ndonjëherë popullit tonë", është shprehur Mehmetaj.

## Agroni ishte një hero dhe luftëtar i pandalshëm

Gjenerali në pension Kudusi Lama në fjalën e tij para të pranishmëve në Gllogjan foli për takimin që ka pasur në kohë lufte me Agron Haradinajn. Sipas tij, Agroni ishte një hero dhe luftëtar i pandalshëm. "Ishe një shok, një djalë, një njeri me shumë vlerë. Unë pata fatin e madh të bëj një copë rrugë me ty, o djalë. Jam i bindur se rrugëtova me një hero, sepse ty Agron në asnjë çast nuk të munguan siguria, thjeshtësia, qartësia për detyrën, kuraja dhe fuqia për të bërë më të mirën për lirinë e atdheut. Ti Agron ishe një luftëtar i gatshëm për sakrificë, për të bërë më të mirën në çdo betejë për luftën e suksesshme. Unë duke qenë pranë teje jam ndier mirë, i sigurt, i motivuar, i plotë dhe me shumë guxim, duke pasur më shumë besim tek ajo që po realizohej. Ti Agron luftove gjithë jetën që nga mosha e fëmijërisë. Për ta çliruar atdheun ti ishe i lirë dhe nuk mund të veproje ndryshe, sepse ishe i biri i Smajl Haradinajt, ishe vëllai i Naimit dhe Nasimit. Ishe bashkëluftëtari dhe bashkëveprimtari më i zoti i



Gllogjanit dhe i Dukagjinit, i Kosovës dhe gjithë kombit shqiptar", ka theksuar Lama.

Ish-i burgosuri politik dhe bashkëveprimtar i Smajl Haradinajt, Hasan Ukëhaxhaj, tha se Agronin e kishte njohur nga fëmijëria. "Sot na ka bashkuar Agroni jo ashtu siç do të dëshironim, por jeta është e tillë dhe na dikton që të takohemi edhe në momente dhimbje si ky i sotmi. Agroni 56-vjeçar, i cili me këtë moshë ka arritur të bëjë shumë për atdheun, do të thosha më shumë se ndonjë tjetër që do të jetonte edhe 100 vjet, dhe kjo po dëshmohet me pjesëmarrjen tuaj në nderimin e tij. Ky djalë i ri, për të cilin kam veç kujtime të mira, meqë kam pasur fatin ta njoh si fëmijë. e ndoqi ngado babanë dhe vëllanë e tij nëpër të gjitha shtigjet e vështira të jetës në rrugëtimin e lirisë për vendin tonë", është shprehur Ukëhaxhaj.

## Agroni ishte zemra dhe palca e UÇK-së

Ish-komandanti i UÇK-së, Agim Çeku, ka theksuar se Dukagjini dhe Kosova po e përcjellin sot në përjetësi Agron Haradinajn, kryengritësin dhe luftëtarin e papërkulur. "Ai ishte zemra dhe palca e UÇK-së. Kjo dhimbje e madhe aq sa rëndon për ju familjarë po aq rëndon mbi bashkëluftëtarët dhe bashkëveprimtarët me të cilët Agroni i ndau vuajtjet e burgjeve dhe istikamet e luftës. Ju familjarë dhe ne nuk guxojmë të ligështohemi sepse Agroni nuk është ligështuar kurrë, ai na ka dhënë forcë dhe kurajë kur ka qenë më së vështiri. Këtë forcë sot duhet ta gjejmë te jeta dhe vepra e tij e lavdishme e cila meriton nderim dhe respekt të pakufi nga ne dhe ata që do të vijnë pas nesh. Nga kjo ceremoni mortore, nga Gllogjani heroik, i përcjell ngushëllimet më të thella mikut dhe bashkëluftëtarit tim Nasimit dhe drejtuesve të tjerë të UÇK-së që janë në Hagë, të cilët me Agronin i bashkon UÇK-ja dhe rruga e lirisë. E di se sa e rëndë ka qenë për Nasimin që nuk ka mundur të qëndrojë pranë vëllait në frymën e fundit. Është tepër e vështirë për të, mungesa në varrim të vëllait dhe pamundësia për të hedhur një grusht dhe mbi varrin e tij, por Nasimi është i fortë e do ta përballojë edhe këtë dhimbje. Ai është atje në mbrojte të UÇK-së dhe lirisë sonë, në mbrojtje të luftës dhe idealeve të Agronit. Ai është atje edhe për Agronin", ka thënë Çeku.

Ish i burgosuri politik dhe bashkëluftëtari Ramë Buja në fjalën e tij tha se Agronin e kishte takuar në rrethana tepër specifike, në një vend shumë specifik. "Kur u takova mendova se është një djalë me moshë mbi 20-vjeçar por, në fakt, ai akoma nuk kishte mbushur të 18-tat. Qëndresa e tij, burrëria e tij, rezistenca e tij dhe këshillat tij për ata që vinin pastaj në →









burgjet e Serbisë, ishte e jashtëzakonshme. Pas burgut, rruga na takoi edhe në rrethana të tjera. U takuam edhe në luftë. Ky djalë dhe ky burrë që sot po përshëndetemi ishte emblemë e lirisë", ka thënë Buja.

Në emër të familjes ka folur e motra e Agronit, Shqipja. Ajo ka falënderuar të gjithë ata që po ndajnë dhimbjen me ta. "Pas gjithë këtyre fjalëve që dëgjuam s'di çfarë t'ju them tjetër, vetëm t'ju falënderoj shumë nga zemra që përkujtuat jetën e vëllait tonë që nga lëvizja e gjerë te lufta e lavdishme e UÇK-së që na solli lirinë. Edhe një herë ju falënderoj shumë të gjithë që keni marrë pjesë në nderimin e vëllait tonë", ka thënë motra e Agronit, Shqipja.

Më 2 mars të këtij viti pushoi së rrahuri zemra e atdhetarit dhe burrit të devotshëm të çështjes kombëtare, Agron Haradinaj, në një spital në Gjermani, si pasojë e torturave të përjetuara nëpër burgjet jugosllave, por edhe nga pasojat e luftës. Emri dhe vepra atdhetare e Agronit do të mbesin gjithmonë në kujtesën e popullit shqiptar.













UÇK
Agron Haradinaj








AGRON
SMAJL
HARADINAJ
17 07 1966
02 03 2023

# Kosova shënon 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 5 mars** - Në Kosovë të dielën ka nisur shënimi i manifestimit treditor të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) teksa krerët shtetërorë nderuan rezistencën e familjes Jashari nga Prekazi.

Krerët shtetërorë nderuan lart pjesëmarrësit dhe të rënët në luftën e fundit dhe Adem Jasharin që njihet si komandant legjendar i UÇK-së dhe familjes së tij.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se liria mban vulën e familjes Jashari. "Kjo liri dhe ky shtet mbajnë vulën e komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe të 3 000 dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mijëra luftëtarëve që i kemi edhe sot mes nesh. Ata janë mishërim i trimërisë dhe nderit", tha Osmani.

Ajo tha se Kosova do të jetë "shtet i pavarur përjetësisht" dhe se ky shtet është amaneti i dëshmorëve. "Duke nderuar përjetësisht Jasharët legjendarë, Prekazin historik dhe të gjithë të rënët nën flamurin madhështor të UÇK-së, marrim frymëzimin dhe energjinë e pashtershme për të marshuar para në rrugëtimin e pandalshëm e të pathyeshëm për ta realizuar idealin e tyre të shenjtë, ruajtjen e mbrojtjen e integritetit territorial e sovranitetit të vendit të pavarur", tha Osmani gjatë ceremonisë së organizuar në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë.

Osmani, që është komandante supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, tha se së bashku me aleatët kjo forcë do të vazhdojë të kontribuojë përmes misioneve humanitare për t'i mbrojtur paqen, lirinë dhe demokracinë në botë.

FSK-ja është në proces të transformimit në ushtri të Kosovës. Procesi ka nisur më 2018 dhe pritet të zgjasë dhjetë vjet.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ushtria e Kosovës ka fillesat në fundin e viteve '80, "atëherë kur Ademi [Jashari] nisi të fliste me shokët për nevojën që kishte Kosova për të pasur ushtri". "Andaj sot ne e përmbushim edhe vizionin e atëhershëm të Adem Jasharit për ushtrinë e Kosovës, teksa e ndihmojmë Forcën e Sigurisë së Kosovës, e cila është në proces të transformimit në Forca të Armatosura të Kosovës, duke shtuar personelin dhe rritur kapacitetet, duke u pajisur me armatime moderne dhe duke u trajnuar e stërvitur në akademitë më të mira ushtarake të vendeve tona aleate", tha ai.

Me rastin e 25-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, ka uruar shëndet e mbarësi për ushtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovë. Ai ka thënë se për të është nder e kënaqësi të jetë përpara Forcave të Sigurisë së Kosovës. Jashari ka bërë thirrje për bashkim sepse vetëm të tillë do të realizohen qëllimet shekullore. "Sot UÇK-ja na ka bashkuar këtu për 25-vjetorin e Epopesë së lavdishme. Është një kënaqësi, krenari me qenë para kësaj ushtrie që e kemi pritur Dem baba Dem. Ju uroj 25-vjetorin! Shëndet e punë të mbarë! Shpresojmë që t'i arrijmë qëllimet tona shekullore, për hir të luftës, gjakut, bijtë e bijave tona, të gjejmë një gjuhë të përbashkët e t'i arrijmë qëllimet. Lavdi dëshmorëve! Lavdi të gjithë të rënëve!", u shpreh Jashari.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se sot e 25 vjet më parë, në Prekazin e bacës Shaban, në mbrojtje të pragut të shtëpisë, dinjitetit dhe kombëtarisë, një familje shqiptare - burra e gra, i madh e i vogël - me guximin mbinjerëzor po luftonte kundër një shteti të tërë - Serbisë agresore. "Aty, më 5, 6 e 7 mars 1998, po shkruhej me shkronja gjaku vepra madhore - Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me komandantin Adem Jashari. Në historinë e një populli nuk ka ngjarje më të rëndësishme sesa lufta për çlirim. Në jetën e një populli nuk ka qëllim më të lartë dhe asgjë më të shtrenjtë sesa liria. Aspirata e popullit tonë ka kaluar nëpër një varg përpjekjesh, luftërash e sakrificash shekullore. Një rrugë e gjatë brezash, e stërmundimshme dhe plot e përplot dhimbje deri te Republika e pavarur dhe sovrane. Aty ku nisi rruga e lirisë, nis Epopeja e lavdisë, themeli i pavarësisë dhe kujtimi i përjetësisë. Nuk do të vdesë kurrë kujtimi i komandantit legjendar Adem Jashari, familjes emblematike Jashari dhe dëshmorëve të lirisë. Lavdi!", ka thënë Konjufca.

Më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, në Prekaz të Skenderajt, forcat serbe sulmuan shtëpitë e familjes Jashari, duke lënë të vrarë mbi 50 anëtarë të kësaj familjeje.

Më 24 mars të vitit 1999, me urdhër të ish-sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Havier Solana, filluan sulmet ajrore të forcave të NATO-s kundër caqeve serbe në Kosovë dhe në Serbi. Pas 78 ditësh bombardime të NATO-s, Sllobodan Millosheviqi, në atë kohë president i Serbisë, u dorëzua në qershorin e vitit 1999 dhe pranoi Marrëveshjen e Kumanovës.

Më 10 qershor Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1244, me të cilën vendosi administratën e përkohshme të OKB-së në Kosovë dhe fuqizoi praninë ushtarake të KFOR-it. Kosova, në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare, ndërtoi institucionet e saj, dhe më 17 shkurt të vitit 2008 shpalli pavarësinë.




## Qytetarët në përvjetorin e Epopesë: Mos t'i harrojmë vuajtjet që kaloi populli ynë

Qindra qytetarë nga mbarë vendi kanë vizituar Kazermën "Adem Jashari" në 25-vjetorin e Epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata kanë vizituar nga afër njësitë ushtarake të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe u treguan fëmijëve të tyre historinë e popullit shqiptar për liri e pavarësi derisa thonë se është shumë e rëndësishme që gjeneratat e reja të kenë më shumë njohuri për luftën e UÇK-së dhe rënien heroike të familjes Jashari në Prekaz. Sipas tyre, historia e familjes Jashari duhet shpjeguar çdo brezi. "Mos t'i harrojmë vuajtjet që kaloi populli ynë", kanë thënë qytetarët.

# KEK-u ende s'i ka paguar punëtorët për punën në fundjavë

PRISHTINË, 5 MARS - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) nuk po e zbaton një vendim të Gjykatës Kushtetuese tash e mbi pesë muaj për t'ua paguar 3.3 milionë euro mbi 1 300 punëtorëve të saj.

Punëtorët e KEK-ut presin të marrin mesatarisht nga 3 500 euro secili për punën e kryer gjatë ditëve të fundjavës e të cilat nuk u ishin paguar më parë.

Rasti ka marrë epilog final ligjor në fund të muajit shtator të vitit 2022 bazuar në një aktvendim të Gjykatës Kushtetuese. Këtë shumë të parave prej 3.3 milionë eurosh KEK-u detyrohet t'ua ndajë punëtorëve si kompensim për ditët e punës gjatë fundjavave për periudhën 2011 deri më 2018.

Madje sindikata e kësaj kompanie publike i ka dhënë ultimatum menaxhmentit të KEK-ut për zbatimin e aktvendimit të Kushtetues, në të kundërtën do të protestojë.

Megjithatë, për moszbatimin e vendimit të Kushtetueses, nga menaxhmenti i KEK-ut nuk janë përgjigjur për "KosovaPress".

Remzi Hashani, i cili tash e disa vjet punon në KEK, thekson për "KosovaPress" se ditët e festave zyrtare dhe të fundjavave nuk paguhen nga kompania. Hashani shpreh brengën për mënyrën sesi janë trajtuar deri tani nga punëdhënësi. Ai derisa kërkon të zbatohen të drejtat e tyre, thotë se ndihen të "shkelur" nga shteti.

"Kemi bërë kërkesë te KEK-u që të na paguhen ditët shtesë, por nuk ka ndodhur dhe na është dashur ta padisim në gjykatë. Të gjitha vendimet e gjykatës i kemi fituar, por KEK-u është duke heshtur. Jemi të zhgënjyer, edhe ashtu punëtorët e prodhimit jemi gjatë gjithë kohës të shkelur, sepse punojmë vikendeve dhe festave", tha Hashani.

Edhe Fatmir Hashani, i cili punon me ndërrime në këtë korporatë energjetike, shprehet i zhgënjyer për mënyrën si po trajtohen nga menaxhmenti dhe kërkon nga shteti më shumë përkushtim për punëtorët e KEK-ut.



# Rezerva Federale paralajmëron rritje të normave të interesit për ta luftuar inflacionin

UASHINGTON, 5 MARS - Rezerva Federale (FED) e Shteteve të Bashkuara të Amerikës thotë se inflacioni mbetet në mënyrë të pakëndshme i lartë dhe se rritja shtesë e normave të interesit është e nevojshme për ta mbajtur atë nën kontroll.

Raporti që u ofron ligjvënësve një përditësim mbi politikën monetare dhe zhvillimet ekonomike vjen vetëm pak ditë përpara se kryetari i FED-it, Jerome Powell, të dëshmojë në Kongres para Komitetit Bankar dhe Komisionit të Shërbimeve Financiare.

Bankierët qendrorë janë në mes të fushatës më agresive që nga vitet 1980 për ta shtypur inflacionin e lartë. Megjithëse Indeksi i Çmimeve të Konsumit ka rënë ngadalë nga niveli i lartë prej 9.1-përqindësh i shënuar në qershor 2022, ai mbetet rreth tri herë më i lartë se mesatarja e para pandemisë Covid-19.



Zyrtarët votuan në shkurt për ta rritur normën bazë të interesit me një çerek pikë përqindjeje në një interval prej 4.5-përqindësh në 4.75 për qind dhe sinjalizuan se një "dy më shumë" rritje janë në tryezë këtë vit. Kjo pasoi një rritje gjysmë pikë në takimin e tyre të dhjetorit dhe katër lëvizje radhazi 75 pikë-bazë përpara kësaj.

Komiteti i përcaktimit të normave të FED-it mblidhet më vonë këtë muaj. Tregjet presin gjerësisht që FED të vazhdojë t'i rrisë normat me një ritëm çerek pikë, por një mori raportesh të të dhënave ekonomike më të nxehta sesa pritej në javët e fundit, duke përfshirë raportin e shpërthimit të vendeve të punës në janar dhe të dhënat zhgënjyese të inflacionit që treguan përhapjen e çmimeve të larta të konsumit, ka ngritur spektrin e një norme më të lartë të pikut ose rritjeve më të pjerrëta.

Departamenti i Punës raportoi në shkurt se indeksi i çmimeve të konsumit u rrit 0.5 për qind në janar 2023, më së shumti në tre muaj. Norma vjetore e inflacionit befasoi gjithashtu në rritje në nivelin 6.4 për qind. Këto të dhëna kanë nxitur disa tregtarë t'i rishqyrtojnë pritjet e tyre për rritjen e normës për vitin, me një numër në rritje investitorësh që tani vënë bast se FED mund t'i rrisë normat më të larta sesa ishte parashikuar më parë. Rreth 33 % e tregtarëve presin që FED ta rrisë normën e fondeve federale me 75 pikë bazë të tjera deri në fund të vitit, ndërsa 64 për qind presin që normat të rriten 50 pikë bazë, sipas të dhënave nga mjeti FedWatch i CME Group.

Zyrtarët e FED-it kanë pranuar se normat mund të kenë nevojë të shkojnë më lart sesa pritej dhe të mbeten të ngritura për më gjatë.

## Posta me pullë postare për 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së

PRISHTINË, 5 MARS - Posta e Kosovës ka realizuar pullë postare për 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së. Në njoftim bëhet me dije se motivi i pullës postare që mban portretin e Shabanit, Ademit dhe Hamzë Jasharit, në sfond ka shqiponjën dykrenore që, siç bëjnë me dije ata, shndërrohet në numrin e përvjetorit të rënies heroike dhe sakrificës së jashtëzakonshme të familjes Jashari. "Filatelia e Postës së Kosovës, në shenjë nderimi të figurave të ndritura nga historia moderne e Republikës së Kosovës, komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve të tjerë për liri, më 5 mars 2023 vë në qarkullim postar emisionin e ri të pullave postare me titull '25-vjetori i Epopesë së UÇK-së'. Emisioni i pullave postare përbëhet nga një pullë postare me nominale €2.10, të shtypur në suvenir tabak të dizajnuar, Zarf të Ditës së Parë dhe Vulë të Ditës së Parë, me qarkullim deri në konsum të plotë", thuhet në njoftim.



# Gazeta 'Daily Observer' boton një recension për librin e Sabri Kiçmarit 'Historia vazhdon'


www.observerbd.com
Weekend Observer
14 | Book Reviews Dhaka Saturday March 4, 2023

History Continues

Sabri Kiçmari

*A kosovan diplomat describes 3 extreme models threatening world peace and democracy…*

Decades after Francis Fukuyama's controversial "End of History" thesis became famous - contradictions, conflicts and turmoil of history have resurfaced once more.

Writer Dr Sabri Kicmari, a Kosovan intellectual, writer and diplomat, have witnessed his motherland erupting in a civil war in the 1990s. It is probably his firsthand experiences drawn during the war coupled with the 1 year old Russian invasion of Ukraine which have triggered in penning this edifying book.

However, his latest book "History Continues" highlights on the return of extreme and militant ideological models in international relations threatening democracy worldwide. He categorically focuses and explains on three particular models.

Ranging from Ultra-Nationalism, Islamic Fundamentalism to Chinese Socialism - the writer has skilfully drawn details about his models on the basis of history, politics, and society - and, most importantly how the 3 models have re-emerged and re-instated within the political dynamics of a different era threatening global peace and democracy.

For a simple and clear understanding, in the last 3 decades three ideological models have continued to exist, resist, develop and oppose the system of liberal democracy and the market economy: Russian ultra-nationalism, Islamic fundamentalism and Chinese socialism. And all 3 have formulated their respective theoretical and ideological doctrines, developed their political and economic systems while significantly impacting the existing world order and geopolitical calculations.

These are informative and analytical chapters for any general reader too.

The book also presents a clear understanding on the Russian invasion of Ukraine and 'Putinism'.

To cut a long story short, "History Continues" aims to draw wider attention to the threats posed to democratic practices and peaceful co-existence by extreme political systems of governance. At the same time, the writer calls for a collective commitment to strengthen democracy in today's world.

Given the chapters, analysis and commentaries presented in the book on the 3 models of continuation of history - "History Continues" is a must read for political science students, academics, intellectuals, journalists, scholars and writers on the related field.

Reviewed by Shahriar Feroze

This reviewer, however, believes an extra model on the unexpected rise of extreme RSS political ideology and its wider affects harming communal harmony and democracy in India would have added more value to the book.

It was also the perfect time for launching the book for drawing a larger global audience in a fast polarising world at a critical time as now.

Another personal observation from this reviewer on the writer's Fukuyama's essay on the "End of History" is that - it may have been founded on scientific, investigative and philosophical methodologies - but the simpler understanding is that history will only end with the destruction of earth - despite whatever dialectical, philosophical and ideological interpretations. On that note - defining and predicting the 'End of History' is a challenging job to determine through ideological lenses.

This is literally the crème-de-la-crème message of "History Continues". The argument supporting "End of History" to be more of an ideology - brought about by the most advanced version of the state system - surely requires deeper introspection since the title itself is ambiguous and misleading.

Lest we forget, hermeneutic methods to analyse ideology and philosophy are also changing with time, thinking and advanced technologies.

Writer Sabri Kiçmari also presents an intellectual-cum-analytical discourse through chapters 2 and 4 on how history continues - interweaving with Fukuyama's inspiration drawn from the traditional German school of idealism and his theories of international relations. That said - it appears the writer, Sabri Kiçmari is perhaps inspired by Right or Old Hegelians - strictly a personal opinion.

Nevertheless, it is always a pleasure to read an informative and analytical book complimented with insightful commentaries, but the truth, however, a theory or any theory is not beyond question when it comes to draw an end of history of the world or whatever subject.

It is here, where critical thinking becomes a priority in life. It is all about think, reflect, ponder, understand and analyse. No point on detailing out which religion or philosophy encourages it.

It is also a fact that ultra-nationalistic creed and extremist leaderships are also encouraging today's political leaderships to practice and promote authoritarian rule over all democratic institutions. But then again democracy has its fair share of weaknesses and limitations in a growing consumerist culture across the world too. Weaknesses and dilemma linked to democratic electoral processes also needs to be addressed too. USA achieved little under Mr Trump's 'Democratic Rule', so people's greater choice conforming to the electoral process needs a close review in this regard.

We expect more such scholarly and insightful publications from kosovan Diplomat-Cum-Writer Sabri Kiçmari.

History Continues
Three Models of the Continuation of History

House of the People

How to Stand up to a Dictator

Dekada pasi teza e diskutueshme e Francis Fukuyamas "Fundi i historisë" u bë e famshme - kontradiktat, konfliktet dhe trazirat janë rishfaqur edhe një herë në rrafshin historik

Autori dr. Sabri Kiçmari, një intelektual, autor dhe diplomat kosovar, ka qenë dëshmitar i shpërthimit të një lufte civile në vitet 1990 në atdheun e tij. Ndoshta janë përvojat e tij të drejtpërdrejta të nxjerra gjatë luftës së bashku me pushtimin njëvjeçar rus të Ukrainës të cilat e kanë nxitur shkrimin e këtij libri edukues.

Sidoqoftë, libri i tij i fundit "Historia vazhdon" e vë theksin te rikthimi i modeleve ideologjike ekstreme dhe militante në marrëdhëniet ndërkombëtare që kërcënojnë demokracinë në mbarë botën. Ai fokusohet dhe shpjegon veçanërisht tre modele të veçantë.

Duke filluar nga Ultra-nacionalizmi, Fundamentalizmi Islamik te Socializmi Kinez - autori ka nxjerrë me mjeshtëri detaje rreth modeleve të tij në bazë të historisë, politikës dhe shoqërisë - dhe, më e rëndësishmja, se si të tre modelet janë rishfaqur dhe rivendosur brenda dinamikave politike të një epoke tjetër që kërcënon paqen dhe demokracinë globale.

Për një kuptim të thjeshtë dhe të qartë, në tri dekadat e fundit tre modele ideologjike kanë vazhduar të ekzistojnë, rezistojnë, zhvillojnë dhe kundërshtojnë sistemin e demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut: ultra-nacionalizmi rus, fundamentalizmi islamik dhe socializmi kinez. Dhe të tre kanë formuluar doktrinat e tyre teorike dhe ideologjike përkatëse, kanë zhvilluar sistemet e tyre politike dhe ekonomike, duke ndikuar ndjeshëm në rendin ekzistues botëror dhe kalkulimet gjeopolitike.




Këta janë kapituj informues dhe analitikë për çdo lexues në përgjithësi.

Libri gjithashtu paraqet një kuptim të qartë mbi pushtimin rus të Ukrainës dhe 'Putinizmin'.

Për të shkurtuar një rrëfim më të gjatë, "Historia vazhdon" synon të tërheqë vëmendjen më të gjerë ndaj kërcënimeve të paraqitura ndaj praktikave demokratike dhe bashkëjetesës paqësore nga sistemet ekstreme politike të qeverisjes. Në të njëjtën kohë, autori bën thirrje për një angazhim kolektiv për të forcuar demokracinë në botën e sotme.

Nisur nga kapitujt, analizat dhe komentet e paraqitura në librin mbi tre modelet e vazhdimit të historisë - "Historia vazhdon" është një domosdoshmëri për studentët e shkencave politike, akademikët, intelektualët, gazetarët, studiuesit dhe autorët e fushës përkatëse.

Recensuesi, megjithatë, beson se një model shtesë mbi ngritjen e papritur të ideologjisë politike ekstreme të RSS dhe ndikimet e saj më të gjera duke dëmtuar harmoninë dhe demokracinë komunale në Indi do t'i kishte shtuar më shumë vlerë librit.

Do të ishte gjithashtu koha e përkryer për shpërndarjen e librit për të tërhequr një audiencë më të madhe globale në një botë të polarizuar me shpejtësi në një kohë kritike si tani.

Një tjetër vëzhgim personal nga recensuesi mbi esenë e autorit për "Fundin e Historisë" të Fukuyamas është se - ajo mund të jetë bazuar në metodologji shkencore, investigative dhe filozofike - por kuptimi më i thjeshtë është se historia do të përfundojë vetëm me shkatërrimin e tokës - pavarësisht çfarëdo interpretimi dialektik, filozofik dhe ideologjik. Në këtë kuptim - përcaktimi dhe parashikimi i 'Fundit të Historisë' është një punë sfiduese për t'u përcaktuar përmes linsave ideologjike.

Ky është literarisht mesazhi crème-de-la-crème i "Historia vazhdon". Argumenti që mbështetet se "Fundi i historisë" do të jetë më shumë një ideologji - e sjellë nga versioni më i avancuar i sistemit shtetëror - me siguri kërkon një introspeksion më të thellë pasi vetë titulli është i paqartë dhe mashtrues.

Që të mos harrojmë, metodat hermeneutike për të analizuar ideologjinë dhe filozofinë po ndryshojnë gjithashtu me kalimin e kohës, të menduarit dhe teknologjive të avancuara.

Autori Sabri Kiçmari gjithashtu paraqet një diskurs intelektual-analitik përmes kapitujve 2 dhe 4 se si vazhdon historia - duke u gërshetuar me frymëzimin e Fukuyama-s, të nxjerrë nga shkolla tradicionale gjermane e idealizmit dhe teoritë e tij të marrëdhënieve ndërkombëtare. E thënë kështu - duket se autori, Sabri Kiçmari është ndoshta i frymëzuar nga Hegelianët e Djathtë ose të Vjetër - një mendim rreptësishtë personal.

Sidoqoftë, është gjithmonë kënaqësi të lexosh një libër informues dhe analitik të plotësuar me komente të mprehta, por e vërteta, sidoqoftë, një teori apo cilado teori nuk është jashtë diskutimit, kur bëhet fjalë për të shpjeguar fundin e historisë së botës apo çfarëdo teme tjetër.

Është këtu, ku të menduarit kritik bëhet prioritet në jetë. Gjithçka ka të bëjë me të menduarit, reflektimin, meditimin, të kuptuarit dhe analizën. Nuk ka kuptim për të detajuar se cila fe apo filozofi e inkurajon atë.

Është gjithashtu fakt se kredot ultra-nacionaliste dhe lidershipet ekstremiste po inkurajojnë lidershipet e sotme politike të praktikojnë dhe promovojnë sundimin autoritar mbi të gjitha institucionet demokratike. Por, në anën tjetër, demokracia gjithashtu e ka pjesën e saj të drejtë në dobësitë dhe kufizimet në një kulturë konsumiste në rritje në mbarë botën. Dobësitë dhe dilemat që lidhen me proceset demokratike zgjedhore gjithashtu duhet të adresohen. ShBA-ja arriti pak nën 'sundimin demokratik' të z. Trump, kështu që zgjedhja e lirë e njerëzve, në përputhje me procesin zgjedhor, ka nevojë për një rishikim të qartë në këtë drejtim.

Presim më shumë botime të tilla shkencore dhe të thelluara nga diplomati - autori kosovar Sabri Kiçmari.

Shkruar nga
SHAHRIAR FEROZE

# Poezia nuk komprometohet kurrë



Lenore KANDEL

Poezia nuk komprometohet kurrë. Ajo është manifestim – një përkthim i një vizioni, një iluminizëm, një përvojë. Nëse bëni kompromis, bëheni profet i verbër. Nuk ka kurrfarë kuptimi sot në atë poezi që sot ekziston sall si ushtrim i mirësjelljes. Teknika është e nevojshme për aq kohë sa përdoret si ngritëse e zonja për qartësi, bukuri, vizion; kur dashurohesh me veten ajo prodhon masturbim verbal.

Poezitë që shkruaj kujdesen për të gjitha aspektet e krijesës dhe të gjithë universit nëpër të cilin lëviz. Qëllimi është ngritja e vetëdijes. Çfarë mund të jetë vetëdija mbi atë se si një zog shkallmon qiellin me fluturimin e tij ose vetëdija për vështirësinë dhe nevojën e besimit ose vetëdijen mbi dëshirën për vetëdije dhe, gjithashtu, frikën nga vetëdija. Dhe kjo mund të arrihet përmes bukurisë ose shokut ose orizit, ama drejtimi është gjithmonë drejt një vizioni të qartë, hem brenda hem jashtë.

Kjo kërkon ndershmëri në intimitetin e poetit dhe të poezisë. Një ndershmëri herë e gëzueshme, herë e dhimbshme, drejtuar vetë poetit ose lexuesit ose të dyve. Dy nga poezitë e mia, të botuara në një libër të vogël, për dashurinë fizike dhe thirrjen, njohjen dhe pranimin e hyjnores te njeriu përmes dashurisë fizike. Me fjalë të tjera, një kënaqësi. Një kënaqësi aq e madhe sa të bën të aftë të dalësh nga vetja jote private dhe të marrësh pjesë në hirin e universit. Ky formulim i thjeshtë dhe mjaft i qartë, i zgjeruar dhe në mënyrë poetike i demonstruar, ka ngritur një zemërim të vështirë për t'u besuar. Pjesa më e madhe e një zemërimi të tillë ishte për shkak të përdorimit poetik të disa fjalëve me katër shkronja me origjinë anglo-saksone që nuk u zëvendësuan me më shumë eufemizma.

Prej këtu fillon çështja e gjuhës poetike.

Çdo gjë që është gjuhë është gjuhë poetike dhe nëse fjala e kërkuar nga poeti nuk ekziston në gjuhën që ai njeh, atëherë i takon atij ta zbulojë. Kushti i vetëm kufizues mund të jetë që fjala e saktë e kërkuar nga poezia dhe sall poeti mund të jetë gjyqtari i saj përfundimtar.

Eufemizmat e zgjedhura nga frika janë në pakt me hipokrizinë dhe menjëherë do ta shkatërrojnë poezinë dhe përfundimisht do ta shkatërrojnë edhe poetin.

Çdo formë censure, mendore, morale, emocionale apo fizike, qoftë nga brenda apo nga jashtë, është pengesë kundër vetëdijes. Poezia është e gjallë sepse është një mjet vizioni dhe përjetimi. Nuk është domosdoshmërisht e këndshme. Nuk është domosdoshmërisht e pafajshme. Poezia doli nga klasa e shkollës dhe doli në rrugë dhe kështu prodhoi një rrjedhë pllenimesh të kryqëzuara, të cilat dhanë shumë fryte jetike si për poezinë ashtu edhe për shkollën. Bota akademike prirej ta gjeneronte frikën e kodit infra të kuqe, duke fyer dikë. Vizionet dhe gjuha shpesh ktheheshin të vockla, të nxitura nga një shurdhues. Një poezi u bë aq shpesh një mjet për gjimnastikën letrare.

Poezia e rrugës shmang kurthin e rrugës, ama shumë shpesh humb vizionet e veta për shkak të mungesës së qartësisë, për shkak të shkencës, për shkak të mungesës së artit në zanat. Poezia që është poezi nuk ka nevojë që të klasifikohet sipas dy kornizave të përshkruara më sipër ose në ndonjë mënyrë tjetër. Ti ekziston. Nuk mund të ekzistojë në shoqërinë e censurës. Nëse një poet censuron vizionin e tij, ai nuk e thotë më të vërtetën ashtu siç e sheh. Nëse censuron gjuhën në një poezi, ai nuk përdor ato fjalë që për të janë fjalët më të përsosura që duhet të përdorë.

Ky vetënanifikim i hap rrugën një kufizimi artificial të imponuar mbi një art, drejtimi i të cilit është përtej kufijve të imagjinueshëm. Nuk ka pengesa për poezinë apo profecinë; nga natyra e tyre ato thyejnë çdo pengesë, ato janë shpërthime perceptimi, vija drejt pafundësisë. Nëse një poet gënjen për vizionin e tij, ai gënjen për veten dhe veten; dhe kjo krijon një pengesë të vërtetë. Kur një poet, për oportunizmin e përshkruar si të frikshëm, përdor një gjuhë tjetërfare nga ajo që është e përsosur për poezinë, ai bëhet një person i oportunizmit të frikshëm. Kur një agjent i jashtëm merr përsipër detyrën e censurimit të poezisë, do të thotë të censurojë pranimin e së vërtetës dhe kapërcimin drejt zbulesës. Kur një shoqëri fillon të ketë frikë nga poetët e saj, kjo do të thotë se ajo ka frikë nga vetja. Një shoqëri që ka frikë nga vetja atëherë ajo e ka definuar veten si ferr. Një poezi e shkruar dhe e botuar është në dispozicion për ata që e zgjedhin ta lexojnë. Për mendimin tim, kjo përfshin një përgjegjësi themelore të poetit – i cili e thotë të vërtetën ashtu siç e sheh. Se e thotë me gjithë bukurinë e saj, aftësinë për të befasuar; për të cilën është e aftë, se ajo nxit ndjenjën e saj të habisë; se ajo e përpunon alkiminë brenda gjuhës – këto janë vetë forma dhe ekzistenca e poezisë.

Publiku i poezisë moderne është pak a shumë i ri. Ne lëvizim në një botë ku polaritetet dhe mundësitë e jetës dhe vdekjes ekzistojnë si një prani e vazhdueshme e vetëdijes. Pasi koncepti dhe prakticiteti i shkatërrimit të tepruar, i një potenciali shkatërrues, madje minimizues, u bë ajo që të gjithë e dinë, aura e mundësisë së një vdekjeje kozmike u bë e dukshme. Kishte raste kur të rinjtë mund të futeshin butësisht në jetën e tyre si të moshuar, dhe nëse donin t'i shpërfillnin problemet më të thella të njerëzimit, të marrëdhënies midis njeriut dhe njeriut, një gjë e tillë u bë e lehtë për ta. Epoka jonë sigurisht nuk është një nga ato, dhe zgjedhjet e të rinjve janë të thella e të vështira. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeç djemtë duhet të vendosin nëse do t'i përkushtohen argëtimit kombëtar të vdekjes. Shumë, në vend se ta pranojnë botën e luftës dhe dëshpërimin personal që u propozohet nga shumica e të rriturve, po zgjedhin të shfaqin një mënyrë tjetër jetese, të motivuar drejt kënaqësisë, drejt iluminimit, dhe drejt veprimit të kombit të Përbashkët.

Ato janë zgjedhje të vështira për t'u bërë, që nuk lejojnë arratisje.

Ata që lexojnë poezi moderne një gjë të tillë e bëjnë me kënaqësi, për të ditur më shumë, ngandonjëherë për të gjetur këshilla. Më e pakta që mund të presin është që poeti që ndan pikëpamjet dhe përvojat e veta me ta, ta bëjë këtë pa hipokrizi. Të kompromentosh në poezi nga frika do të thotë ta atrofizosh psikikën. Kompromisi për oportunizëm në poezi është vrasje e butë e vogël e shpirtit.

**Përktheu nga anglishtja Fadil Bajraj. Marrë nga numri 16 i revistës "Akademia"**

# Gruaja tjetër



SHERWOOD ANDERSON

"Jam i dashuruar me gruan time" – tha ai – vërejtje e tepërt, përderisa nuk ia kisha vënë në dyshim besnikërinë ndaj gruas me të cilën ishte martuar. Ecëm së bashku dhjetë minuta dhe ai e tha sërish. U ktheva nga për ta parë në sy. Filloi të fliste dhe më tregoi rrëfenjën që do të shkruaj tani.

Ajo që kishte në mendje ndodhi gjatë asaj që duhet të ketë qenë java me më shumë ngjarje e jetës. Do të martohej të premten pasdite. Të premten e një jave më parë kishte marrë një telegram që e lajmëronte për emërimin në një post qeveritar. Ndodhi diçka tjetër që e bëri shumë krenar dhe të lumtur. E kishte zakon të shkruante në fshehtësi vargje dhe para një viti disa prej tyre ishin shtypur në revista me poezi. Një nga shoqëritë që jep çmime për poezitë më të mira të botuara gjatë vitit, sipas gjykimit të tyre, ia kishte vendosur emrin në krye të listës. Historia e këtij ngadhënjimi u botua në gazetat e qytetit ku kishte lindur, dhe njëra prej tyre e shoqëroi edhe me fotografinë e tij.

Siç pritej, ai ishte i emocionuar dhe në një gjendje nervore mjaft të tensionuar gjatë gjithë asaj jave. Pothuajse çdo mbrëmje shkonte për t'i bërë një vizitë të shkurtër të fejuarës, bijës së një gjykatësi. Kur arrinte atje, shtëpia e saj ishte plot me njerëz dhe ata po merrnin shumë letra, telegrame dhe pako. Ai rrinte pak mënjanë dhe burra e gra shkonin vazhdimisht për t'i folur. E uronin për suksesin në marrjen e postit qeveritar dhe arritjet si poet. Të gjithë dukej se po e lavdëronin dhe kur u kthye në shtëpi për të fjetur nuk arriti të flinte. Të mërkurën në mbrëmje vajti në teatër dhe iu duk sikur pa përjashtim secili nga ata që ishin në sallë e njohu. Të gjithë tundnin kokën dhe buzëqeshnin. Pas aktit të parë pesë ose gjashtë burra dhe dy gra lanë vendet e tyre për t'u mbledhur rreth tij. U krijua një grup i vogël. Të huajt e ulur përgjatë të njëjtit rresht në ndenjëse zgjatën qafën për të parë nga ai. Kurrë nuk kishte marrë kaq shumë vëmendje më parë, dhe tani e pushtoi një ethe pritjeje.

Siç shpjegoi kur më tregoi për përvojën e tij, për të ishte një kohë krejtësisht jonormale. Ndihej sikur pluskonte në ajër. Kur u shtri në shtrat, pasi pa kaq shumë njerëz dhe dëgjoi kaq shumë fjalë lavdërimi, mendja po i vinte vërdallë. Kur mbylli sytë një turmë njerëzish pushtuan dhomën. Dukej sikur mendjet e të gjithë njerëzve të qytetit ishin të përqendruara tek ai. E pushtuan fantazitë më absurde. E imagjinonte veten duke hipur në një karrocë që kalonte nëpër rrugët e një qyteti. Dritaret hapeshin dhe njerëzit dilnin me vrap nga dyert e shtëpive. "Ja ku është. Ky është ai", bërtitnin ata dhe nga këto fjalë ngrihej një britmë e gëzuar. Karroca u fut në një rrugë të bllokuar me njerëz. Njëqind mijë palë sy e shikonin lart. "Ja ku je! Si arrite të bëhesh ky që je!" dukej sikur thoshin ata sy.

Miku im nuk e shpjegonte dot nëse njerëzit ishin të ngazëllyer ngaqë ai kishte shkruar një poezi të re apo nëse, në postin e ri qeveritar, kishte kryer ndonjë veprim të guximshëm. Apartamenti ku jetonte asokohe ishte në një rrugë me banesa përgjatë majës së një vargu shkëmbinjsh, larg në skaj të qytetit, dhe nga dritarja e dhomës së gjumit mund të shihte pemët poshtë dhe çatitë e fabrikave ndanë një lumi. Meqë s'mund të flinte dhe fantazitë ia pushtonin pareshtur mendjen duke e mbushur gjithnjë e më shumë me emocion, ai u ngrit nga shtrati dhe u përpoq të mendonte.

Siç do të ishte e natyrshme në rrethana të tilla, u përpoq t'i kontrollonte mendimet, por kur u ul pranë dritares dhe ishte zgjuar plotësisht, ndodhi diçka shumë e papritur dhe poshtëruese. Nata ishte e kthjellët dhe e mirë. Kishte hënë. Ai donte të ëndërronte për gruan që do të bëhej gruaja e tij, të mendonte vargje për poezi fisnike ose të bënte plane që do të ndikonin në karrierë. Për habinë e tij, mendja s'pranoi ta bënte diçka të tillë.

Në cep të rrugës ku jetonte ishte një dyqan i vogël purosh dhe një stendë gazetash e një burri të shëndoshë dyzet vjeç dhe e të shoqes, një grua e vogël, energjike me sy gri që i ndrisnin. Në mëngjes ndaloi aty për të blerë një gazetë para se të zbriste në qytet. Ndonjëherë shihte vetëm burrin e shëndoshë, por shpesh burri s'dukej kund dhe ishte gruaja ajo që e priste. Ajo ishte, siç më siguroi të paktën njëzet herë kur më tregoi rrëfenjën, njeri shumë i zakonshëm, pa asgjë të veçantë apo që të meritonte vëmendje, por për disa arsye që nuk mund t'i shpjegonte prania e saj e trazonte jashtëzakonisht shumë. Gjatë asaj jave, në mes të atij shpërqendrimi, ajo ishte i vetmi nga njerëzit që njihte, e cila kuptohej fare lehtë se nuk i shqitej nga mendja. Kur donte aq shumë të kishte mendime fisnike, vetëm për të mund të mendonte. Përpara se të dinte se çfarë po ndodhte, imagjinata e tij ishte pushtuar nga ideja e të pasurit marrëdhënie dashurie me gruan.

"S'mundesha ta kuptoja dot veten", pohoi duke më treguar historinë. "Natën, kur qyteti ishte i qetë dhe duhej të isha në gjumë, mendoja për të gjatë gjithë kohës. Pas dy ose tre ditësh të tilla, vetëdija për të u bë pjesë e mendimeve të ditës. Mendja m'u bë lëmsh i vërtetë. Kur shkova për të parë gruan që tani është ime shoqe, kuptova se dashuria ime për të nuk ishte prekur aspak nga mendimet e mia të mprashta. Kishte vetëm një grua në botë që doja të jetonte me mua, të isha shoqja ime në sipërmarrjen për të përmirësuar karakterin dhe pozicionin tim shoqëror në botë, por hë për hë, e kuptoni, doja që kjo gruaja tjetër të ishte në krahët e mi. Ajo kishte hyrë në qenien time. Nga të gjitha anët njerëzit thoshin se isha njeri i madh që do të bënte gjëra të mëdha, dhe ja në çfarë gjendje isha. Atë mbrëmje, kur shkova në teatër, vajta në shtëpi sepse e dija që s'do të mund të flija dhe për të kënaqur shtysën e bezdisshme brenda vetes shkova dhe qëndrova në trotuar para shitores së duhanit. Ishte një ndërtesë dykatëshe dhe e dija që gruaja jetonte lart me të shoqin. Për një kohë të gjatë qëndrova në errësirë me trupin e mbështetur në murin e ndërtesës dhe më pas mendova për ata të dy atje lart, pa dyshim në shtrat së bashku. Kjo më tërboi.

"Pastaj u zemërova më shumë me veten. Shkova në shtëpi dhe u futa në shtrat duke shkumëzuar nga inati. Janë disa libra me vargje dhe disa shkrime në prozë që gjithmonë më kanë prekur thellë dhe kështu vendosa disa libra në tavolinën pranë shtratit.

"Zërat në libra ishin si zërat e të vdekurve. S'i dëgjova. Fjalët e shtypura në rreshta s' më depërtonin në ndërgjegje. U përpoqa të mendoja për gruan që doja, por edhe portreti i saj ishte bërë diçka e largët, diçka me të cilën hë për hë më dukej se s'kisha të bëja. U shemba dhe u rrotullova në shtrat. I ndjeva i mjerë".

"Të enjten në mëngjes hyra në shitore. Gruaja ishte vetëm. Mendoj që e dinte se si ndihesha. Ndoshta kishte menduar vazhdimisht për mua ashtu siç kisha menduar unë për të. Një buzëqeshje e dyshimtë, ngurruese iu shfaq në cepat e buzëve. Kishte veshur një fustan të bërë prej një cohe të lirë dhe ishte i grisur në

shpatull. Duhet të ketë qenë dhjetë vjet më e madhe se unë. Kur u përpoqa të vendosja qindarkat në banakun e xhamit pas të cilit rrinte, dora m'u dridh prandaj qindarkat lëshuan një tringëllimë të mprehtë. Kur fola, zëri që më doli nga fyti s'dukej si diçka që më kishte përkitur ndonjëherë. Mezi shkoi përtej një pëshpëritje të mbytur. "Të dëshiroj", – i thashë. "Të dëshiroj kaq shumë. A mund të arratisesh nga burri? Eja tek unë në banesën time sonte në orën shtatë.

"Po, gruaja erdhi në orën shtatë. Atë mëngjes s'tha asgjë. Ndoshta për një minutë thjesht qëndruam duke parë njëri-tjetrin. Vetëm ajo ekzistonte për mua, e kisha harruar gjithçka tjetër në botë. Pastaj ajo tundi kokën dhe unë u largova. Tani që e mendoj, s'mbaj mend të ketë shqiptuar qoftë edhe një fjalë. Erdhi në orën shtatë dhe ishte errësirë. Duhet ta kuptoni se kjo ndodhi në muajin tetor. Nuk kisha ndezur asnjë dritë dhe e kisha larguar shërbëtorin tim.

"Gjatë asaj dite nuk isha aspak mirë. Disa burra erdhën për të më parë në zyrë, por unë u ngatërrova si mos më keq kur u përpoqa të këmbeja dy fjalë me ta. Ata thanë se hutimin e kisha prej martesës që po afrohej dhe u larguan duke qeshur.

"Në mëngjes, vetëm një ditë para martesës, mora një letër të gjatë dhe shumë të bukur nga e fejuara. Një natë më parë edhe ajo s'kishte mundur të flinte dhe ishte ngritur nga shtrati për të shkruar letrën. Gjithçka thoshte në të ishte shumë e mprehtë dhe e vërtetë, por ajo vetë, si një qenie njerëzore e gjallë, dukej se ishte bërë e largët. Më dukej se ishte si një zog që fluturonte atje tej në qiejt të largët, dhe unë isha si djali i hutuar, këmbëzbathur që rri në rrugën me pluhur para një shtëpie ferme dhe vështron siluetën e saj të zbehtë. Pyes veten nëse më kuptoni se çfarë dua të them?

"Për sa i përket letrës. Në të ajo, gruaja që po zgjohej te ajo, derdhi gjithçka kishte në zemër. Sigurisht që s'dinte asgjë për jetën, por ishte grua. Ajo ishte plandosur në shtrat, mendoj, nervoze dhe e rraskapitur njësoj si unë. E kishte kuptuar se një ndryshim i madh po i ndodhte në jetë dhe ishte edhe e lumtur, edhe e frikësuar. Rrinte shtrirë duke menduar për të gjitha këto. Pastaj ishte ngritur nga shtrati dhe kishte filluar të fliste me mua duke kuvenduar me anë të asaj letre. Më thoshte se sa e frikësuar dhe e gëzuar ishte. Si shumica e vajzave të reja, kishte dëgjuar gjëra që pëshpëriteshin lart e poshtë. Në letër tregohej shumë e ëmbël dhe mirë. "Kur të ketë kaluar shumë kohë, pasi të jemi martuar, do të harrojmë se jemi burrë dhe grua", kishte shkruar ajo. "Do të jemi qenie njerëzore. Duhet të mbani parasysh që unë jam e paditur dhe shpesh do të sillem si budallaqe. Ju duhet të më doni dhe të jeni shumë i durueshëm dhe i sjellshëm me mua. Kur të di më shumë, kur pas një kohe të gjatë të më kesh mësuar për jetën, do të përpiqem të ta shpërblej, do të dua me butësi dhe pasion. E ndiej që i kam të dyja këto brenda meje, përndryshe nuk do të kisha dashur kurrsesi të martohesha. Kam frikë por jam edhe lumtur. O, jam shumë e kënaqur që koha e martesës është kaq e afërt".

"Tani e shihni mjaft qartë se në çfarë telashi të madh isha. Në zyrën, pasi lexova letrën e të fejuarës, u bëra menjëherë shumë i vendosur dhe i fortë. Mbaj mend që u ngrita nga karrigia dhe nisa të ecë vërdallë, krenar që do të isha bashkëshorti i një gruaje kaq fisnike. Menjëherë ndjeva një lidhje me të ashtu siç isha ndjerë për vete para se të kuptoja se sa krijesë e dobët isha. Për të shmangur çdo pasiguri, mor vendimin e madh që s'do të tregohesha i dobët. Në orën nëntë të asaj mbrëmjeje kisha ndërmend të vrapoja për të parë të fejuarën time. "Tani jam shumë mirë", – thashë me vete. "Bukuria e karakterit të saj më ka shpëtuar nga vetja. Do të shkoj në shtëpi tani dhe do ta largoj gruan tjetër". Në mëngjes i telefonova shërbëtorit tim dhe i thashë se nuk doja që ai të ishte në banesë atë mbrëmje dhe mora telefonin për t'i thënë shërbëtorit të rrinte në shtëpi. "Pastaj më erdhi një mendim: "S'duhet ta kem nëpër këmbë në asnjë rast", i thashë vetes. "Çfarë do të mendojë ai kur të shohë një grua që vjen në shtëpinë time në mbrëmjen para ditës që do të martohem?" E ula dorezën e telefonit dhe u përgatita të shkoj në shtëpi. "Nëse dua që shërbëtori të mos jetë aty, kjo ndodh për të vetmen arsye sepse s'dua që të më dëgjojë kur të flas me të. Nuk mund të jem i pasjellshëm me gruan. Do të më duhet të jap një lloj shpjegimi, – thashë me vete.

"Gruaja erdhi në orën shtatë dhe, siç mund ta keni marrë me mend, e lashë të hynte dhe e harrova vendimin që kisha marrë. Ka të ngjarë që s'kam pasur kurrë qëllim të bëja diçka tjetër. Në derë ishte një zile, por ajo nuk i ra, ajo trokiti shumë butë. Mua më duket se gjithçka që ajo bëri atë mbrëmje ishte e butë dhe e qetë por shume e vendosur dhe e shpejtë. A jam i qartë në këtë që po them? Kur erdhi, unë po qëndroja brenda pragut, ku kisha gjysmë ore që rrija në këmbë dhe prisja. Duart më dridheshin ashtu siç më dridheshin në mëngjes kur sytë e saj më panë dhe kur u përpoqa të vendosja qindarkat në banakun e dyqanit. Kur hapa derën ajo u fut shpejt brenda dhe unë e rroka në krahë. Qëndruam bashkë në errësirë. Duart nuk s'më dridheshin më. U ndjeva shumë i lumtur dhe i fortë.

"Megjithëse jam munduar të bëj gjithçka të qartë, s'të kam thënë se si është gruaja me të cilën u martova. E shihni, kam theksuar gruan tjetër. Të bëra pohimin e papritur që e dua gruan time dhe për një burrë mendjemprehtë si ty kjo s'ka kurrfarë kuptimi. Të them të drejtën, do të ndihesha më rehat po të mos kisha filluar të flisja për këtë çështje. Është e pashmangshme që t'ju jap përshtypjen se jam i dashuruar me gruan e duhanshitësit. S'është e vërtetë. Pa dyshim, isha shumë i vetëdijshëm për të gjatë gjithë javës para martesës, por pasi erdhi tek unë në banesë, ajo m'u largua plotësisht nga mendja

"A po them të vërtetën? Po rrekem aq sa mundem të të tregoj çfarë më ka ndodhur. Po them që nga ajo mbrëmje s'kam menduar më për gruan që erdhi në banesën time. Tani, që të jemi besnik ndaj fakteve të çështjes, kjo s'është e vërtetë. Atë mbrëmje vajta te e fejuara në orën nëntë, siç më kishte kërkuar në letër. Në një farë mënyre nuk mund të shpjegoj se pse gruaja tjetër shkoi në shtrat me mua. Ja çfarë dua të them – e kuptoni se kisha menduar që nëse do të ndodhte diçka mes meje dhe gruas së duhanshitësit, unë s'do të mund ta bëja dot martesën. "O njëra, o tjetra", thosha me vete.

"Në të vërtetë, vajta ta takoj të shtrenjtën time atë mbrëmje i mbushur me një besim të ri te e ardhmja e jetës tonë së bashku. Kam frikë se mos e ngatërroj edhe më shumë këtë çështje duke u përpjekur ta shkoqis. Sapo thashë që gruaja tjetër, bashkëshortja e duhanshitësit shkoi në shtrat me mua. Në fakt, s'dua ta them këtë. Ajo që dua të them është se diçka nga besimi në dëshirat që kishte dhe guximi për të depërtuar në thelbin e gjërave ishte njësoj si të shkonte në shtrat me mua. A e kuptoni? Kur arrita në shtëpinë e të fejuarës ishte një grumbull njerëzish që vinin rrotull. Disa ishin të afërm nga vende të largëta që nuk i kisha dëgjuar më parë. Ajo ngriti sytë menjëherë kur hyra në dhomë. Fytyrën duhet ta kem pasur flakë të kuqe. S'e kisha parë kurrë aq të emocionuar. Kishte menduar se letra e saj më kishte prekur thellë dhe pa dyshim që po. Brofi në këmbë dhe vrapoi për të më takuar. Ngjante me një fëmijë të gëzuar. Pikërisht përpara njerëzve që kthyen kokat me vështrime pyetëse, ajo tha atë që kishte në mendje. "O, jam shumë e lumtur", – rënkoi. "Ti e ke kuptuar. Ne do të jemi dy qenie njerëzore. Nuk është e detyruar të jemi burrë e grua".

"Siç mund ta merrni me mend, të gjithë qeshën, por jo unë. Gati u mbusha me lot. Isha aq i lumtur sa doja të bërtisja. Ndoshta e kuptoni se çfarë dua të them. Në zyrë, atë ditë kur lexova letrën që kishte shkruar e fejuara ime, i kisha thënë vetes: "Do të kujdesem unë për ty e shtrenjta vogëlushe". Kishte një lloj ndjenje vetëkënaqësie, në këtë pohim, besoj e kuptoni. Në shtëpinë e saj, kur ajo qante asisoj, ndërsa të gjithë qeshnin, ajo që i thashë vetes pak a shumë kjo: "Do të kujdesemi për veten, vogëlushe". Diçka të tillë i pëshpërita te veshi. Të them të drejtën, e harrova fare pozitën time shoqërore. Fryma e gruas tjetër ishte arsyeja. Para se të tjetër të mblidheshin rreth nesh si miza, e shtrëngoja të fejuarën time dhe putheshim. Njerëzit mendonin se ishte mrekulli që na ngjallte kaq shumë dashuri prania njëri-tjetrit. Por se çfarë do të kishin menduar po ta dinin të vërtetën për mua, një Zot e di!

"Janë bërë tashmë dy herë që them se pas asaj mbrëmje s'kam menduar më për gruan tjetër. Kjo është vetëm deri diku e vërtetë, por nganjëherë në mbrëmje kur jam duke ecur vetëm në rrugë ose në park siç po ecim tani, dhe kur muzgu vjen butësisht dhe shpejt siç ka ardhur sonte, ndjesia e pranisë së saj ma pushton fort trupin dhe mendjen. Pas atij takimi s'e pashë më kurrë. Të nesërmen isha i martuar dhe nuk u ktheva kurrë më në rrugën e saj. Megjithatë më ndodh shpesh që ndërsa po ec, siç po bëj tani, më zotëron një ndjesi e beftë dhe e mprehtë tokësore. Është sikur të jem një farë në tokë dhe të kenë ardhur shirat e ngrohtë të pranverës. Është sikur të mos jem njeri por pemë.

"Dhe tani, ti e sheh, jam i martuar dhe gjithçka është në rregull. Martesa është për mua një fakt shumë i bukur. Nëse do të thuash që martesa ime s'është e lumtur, mund të të quaj gënjeshtar sepse po them të vërtetën absolute. U mundova të të tregoj për këtë gruan tjetër. Ndiej një lloj lehtësimi kur flas për të. S'e kam bërë kurrë më parë. Pyes veten pse isha kaq budalla sa të kisha frikë se mos të lija përshtypjen se s'jam i dashuruar me gruan time. Po të mos kisha besuar inatinktivisht në mirëkuptimin tënd, s'do të kisha folur. Siç janë punët tani, shoh se ndihem pak i trazuar. Sonte do të mendoj për gruan tjetër. Më ndodh herë pas here. Do të ndodhë pasi te kem rënë në shtrat. Ime shoqe fle në dhomën ngjitur dhe dera lihet gjithmonë e hapur. Do të dalë hëna sonte, dhe kur nata është me hënë, fasha të gjata drite bien mbi shtratin e saj. Sonte do të zgjohem në mesnatë. Ajo do të jetë e shtrirë në gjumë me një krah të hedhur mbi krye.

"Për çfarë po flas? Një burrë s'flet për bashkëshorten e shtrirë në shtrat. Dua të them se, për shkak të kësaj bisede, sonte do të mendoj për gruan tjetër. Mendimet e mia s'do të jenë si ato që kisha një javë para se të martohesha. Do të pyes veten se çfarë ka ndodhur me gruan. Për një çast do ta ndjej përsëri duke e shtrënguar pranë vetes. Do të mendoj se si gjatë një ore kam qenë më afër saj se sa kam qenë ndonjëherë me njeri. Atëherë do të mendoj për kohën kur do të jem po kaq afër time shoqeje. Ajo është ende, e shihni, një grua zgjuese. Për një çast do t'i mbyll sytë dhe sytë e mprehtë, të vendosur të gruas tjetër do të shikojnë në të mitë. Koka ime do të notojë dhe sakaq do t'i menjëherë hap sytë dhe do të shoh përsëri bashkëshorten time të dashur me të cilën kam marrë përsipër përgjegjësinë të jetoj jetën time. Pastaj do të fle dhe kur të zgjohem në mëngjes, do të jetë krejt si atë mbrëmje kur dola nga banesa ime e errët pasi kisha përjetuar përvojën më të domethënëse të jetës sime. Ajo që dua të them, besoj e kuptoni, është se për mua, pasi të zgjohem, gruaja tjetër do të jetë zhdukur plotësisht".

*Përktheu nga anglishtja Granit Zela. Marrë nga numri 16 i revistës "Akademia"*







# Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

## Fitore e lehtë e Besës ndaj Prishtinës

**Pejë, 5 mars** - Besa Famgas nuk ka pasur telashe për ta fituar ndeshjen me Prishtinën. Të shtunën mbrëma në "Karagaçi", kampionia në fuqi, Besa, e mposhti Prishtinën me rezultat 45:24. Ndeshja i ka takuar javës së 20-të të Superligës A. Ende pa u luajtur minuta e dhjetë, Besa Famgas nisi shkëputjen në rezultat. Në minutën e 22-të epërsia e pejanëve u rrit në dhjetë gola dhe më nuk kishte rivalitet. Denis Shabanoviq shënoi 10 gola për Besën, ndërsa tetë i kishte Arbios Mushkolaj. Me shumë pritje u dallua portieri Mursel Mehmeti. Albi Gjuka e Sergio Barreto shënuan nga pesë gola për Prishtinën. Besa Famgas udhëheq në tabelë me 35 pikë. Prishtina mbetet e treta me 21 pikë. Trepça është e dyta me 24 pikë.



# Ballkani ndan pikët me Prishtinën

Një penallti e realizuar në kohën shtesë nga Albion Rrahmani e ka shpëtuar Malishevën nga humbja në derbin ndaj Prishtinës, i cili u zhvillua në Lipjan. Baras kanë luajtur edhe Trepça '89 dhe Malisheva, derisa të shtunën Drita e ka mposhtur Llapin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 5 mars** - Ndeshja kryesore e javës së 23-të në Superligën e Kosovës në futboll mes Prishtinë dhe Ballkanit nuk sjelli fitues, pasi përfundoi me rezultat 2-2. Kjo ndeshje u zhvillua në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0, kurse kryeqytetasit shënuan dy gola brenda dhjetë minutave lojë, kurse autor të golave ishin Bujar Pllana dhe Endrit Krasniqi. Lojtarët e skuadrës kampione nuk u dorëzuan, dhe arritën të rikthehen në lojë, duke barazuar rezultatin me golat e Nazmi Gripshit në minutën e 80-të nga distanca dhe në nga penalltia në minutat shtesë Albion Rrahmani. Pas kësaj ndeshje, Ballkani vazhdon të jetë në pozitën e parë me 49 pikë, derisa Prishtina është në vendin e katërt me 31 pikë. Të dielën është zhvilluar edhe ndeshja mes Trepçës '89 dhe Malishevës, e cila përfundoi me rezultat 0-0.



Tri ndeshjet e tjera të kësaj jave u zhvilluan të shtunën. Drita e mposhti Llapin me rezultat 2-0, me golat e realizuar nga Kushtrim Shabani (autogol) dhe Almir Ajzerajt. Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Gjilani dhe atë si mysafir në duel me Dukagjinin, me rezultat 1-0, me golin e Mevlan Zekës, si dhe Drenica që i ka dhënë fund serisë negative, duke e mposhtur Ferizajn, 1-0, me golin e Bintsouka Koxy.

**SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Ballkani | 2-2 |
| Trepça '89 - Malisheva | 0-0 |
| Dukagjini - Gjilani | 0-1 |
| Drenica - Ferizaj | 1-0 |
| Drita - Llapi | 2-0 |

**Tabela**

| | |
|---|---|
| 1. Ballkani | 49 pikë |
| 2. Drita | 47 |
| 3. Gjilani | 38 |
| 4. Prishtina | 31 |
| 5. Llapi | 29 |
| 6. Dukagjini | 26 |
| 7. Malisheva | 25 |
| 8. Drenica | 23 |
| 9. Trepça '89 | 23 |
| 10. Ferizaj | 21 |

# Bashkimi fiton derbin e qytetit

**Prizren, 5 mars** - Në një sfidë shumë interesante, Bashkimi ka mundur Ponte Prizrenin me shifrat 73:77 (21:16, 18:17, 20:20, 14:24). Takimi që u zhvillua në Rahovec ishte në kuadër të javës së 24-t të Prince Caffe Superligës. Ndeshjen më mirë e nisi Ponte Prizreni që kishte deri në shtatë pikë epërsi, ndërsa çerekun e parë e fituan 21:16. Periudha e dytë ishte më e barabartë, me Bashkimin që afrohej në rezultat dhe Ponte Prizrenin që shkëputej, ndërsa pjesa e parë përfundon 39:33. Prizreni epërsinë më të lartë e kishte 12 pikë, 57:45, por basketbollistët e Bashkimit sërish u rikthyen, ku rezultati pas 30 minutash ishte 59:53. Pesë minuta nga fundi, Ponte Prizreni po fitonte 71:61, megjithatë, asgjë nuk kishte përfunduar. Portokallezinjtë me një seri të jashtëzakonshme përmbysin rezultatin dhe triumfojnë 73:77. Më i miri i Ponte Prizrenit ishte Urim Zenelaj me dhjetë pikë e dhjetë kërcime, kurse i Bashkimit ishte Daniel Lekndreaj me 21 pikë, 14 kërcime e pesë asistime. Ponte Prizreni numëron shtatë fitore e 17 humbje, ndërsa Bashkimi ka 11 fitore e 13 humbje.





## Roma fiton derbin ndaj Juventusit

**Romë, 5 mars** - AS Roma ka mundur me shifrat 1-0 Juventusin në supersfidën e kësaj jave. Ekipi i Jose Mourinhos u tregua cinik. Ekipi kryeqytetas nuk godite shumë herë portën, por ishte mjaft i rrezikshëm. Konkretizimi erdhi në minutën e 53-të, pas një goditje të Manqinit. Gjuajtje kirurgjikale e tij, vetëm rrjeti mund ta ndalte. Po Manqini mund të kthehej në protagonist negativ pak më vonë, pasi për pak sa nuk shënoi autogol. Roma renditet në vendin e katërt me 47 pikë. Juve është në vendin e tetë me 35 pikë.

## Liverpooli shpartallon Unitedin

**Liverpool, 5 mars** - Liverpooli i ka ruajtur golat dhe spektaklin për ndeshjen ndaj Manchester United këtë sezon duke e turpëruar në shifrat 7-0. Një ndeshje e jashtëzakonshme, që do të mbetet tashmë në histori. Skuadra e Klopp është treguar e pamëshirshme mbrëmjen e sotme. Në pjesën e parë do të zhbllokonte ndeshjen Gakpo, ndërkohë që e dyta do të fliste e gjitha për Liverpoolin. Gakpo do të kompletonte dopietën personale, ndërkohë që të njëjtën gjë do të bënin dhe Nunez dhe Salah, duke shënuar secili prej tyre nga dy gola. Në minutën e 88-të kishte kohë dhe për Firminon që të shënonte dhe golin e 7-të në këtë ndeshje historike për Liverpoolin.



TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.769 të datës 03.03.2023, UD Kryeshefi Ekzekutiv i NPK " Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

**K O N K U R S I J A S H T Ë M**

**Pozita e Punës: Riparues Karroserie dhe Autongjyrosës**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Kohëzgjatja:** 1 vit me mundësi vazhdimi
**Periudha provuese:** 3 muaj
**Niveli i Pagës**: XV

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**
- Shkollim profesional nga fusha e auto-ngjyrosjes apo të ngjashme;
- 1 vit përvojë pune në fushën përkatëse;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.
**Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.
**Mënyra e Aplikimit:**
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkursi është i hapur nga data 06.03.2023 dhe përfundon më datë 20.03.2023 deri në ora 16:00.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 06.03.2023

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.768 të datës 03.03.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK " Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

**K O N K U R S I J A S H T Ë M**

**Pozita e Punës: Elektricist**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Kohëzgjatja:** 1 vit me mundësi vazhdimi
**Periudha provuese:** 3 muaj
**Niveli i Pagës**: XV

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**
- Shkollim profesional nga fusha e elektrikes
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
- Dëshmi mbi shkollimi
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.
**Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.
**Mënyra e Aplikimit:**
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com.
Konkursi është i hapur nga data 06.03.2023 dhe përfundon më datë 20.03.2023 deri në ora 16:00.
**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 06.03.2023

1

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022, kao i Odlukom br.769 od 03.03.2023, Izvršni direktor UD NPK „Trafiku Urban" S.A., Priština, objavljuje:

**J A V N I K O N K U R S**

**Radno mesto**: Autolimari i farbari
**Broj pozicija**: 1 (jedan)
**Trajanje:** 1 godina sa mogućnošću produženja
**Probni period**: 3 meseca
**Nivo plate:** XV
**Dužnosti i odgovornosti:**
• Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.
**Kvalifikacije i veštine:**
• Stručno obrazovanje iz oblasti autofarbara ili slično;
• 1 godina radnog iskustva u relevantnoj oblasti;
• Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
• da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;
**2. Potrebna dokumentacija:**
• Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
• Dokaz o obrazovanju;
• Kopija lične karte;
• Dokaz o radnom iskustvu
• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.
**Opšte informacije:**
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.
**Način primene**:
Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkurs je otvoren od 06.03.2023 i završava se 20.03.2023 do 16:00 časova.

**Napomena:** Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.
Datum: 06.03.2023

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br. 768 od 03.03.2023.godine, UD Glavnog Izvršnog Direktora NPK „Trafiku Urban" SH.A., Priština, objavljuje:

**J A V N I K O N K U R S**

**Radno mesto**: Električar
**Broj pozicija**: 1 (jedan)
**Trajanje**: 1 godina sa mogućnošću produženja
**Probni period**: 3 meseca
**Nivo plate**: XV
**Dužnosti i odgovornosti:**
• Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.
**Kvalifikacije i veštine:**
• Stručno obrazovanje iz oblasti električne energije
• Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
• Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.
**2. Potrebna dokumentacija:**
• Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
• Dokaz o obrazovanju
• Kopija lične karte;
• Dokaz o radnom iskustvu
• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.
Opšte informacije:
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.
**Način primene:**
Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com.
Konkurs je otvoren od 06.03.2023 i završava se 20.03.2023 do 16:00 časova.
**Napomena:** Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 06.03.2023

2

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.767 të datës 03.03.2023, UD i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK " Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e Punës: Mekanik**
**Numri i pozitave:** 4 (katër)
**Kohëzgjatja:** 1 vit me mundësi vazhdimi
**Periudha provuese:** 3 muaj
**Niveli i Pagës**: XV

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Shkollim profesional nga fusha e mekanikës
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
- Dëshmi mbi shkollimi
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Mënyra e Aplikimit:**
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com.
Konkursi është i hapur nga data 06.03.2023 dhe përfundon më datë 20.03.2023 deri në ora 16:00.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 06.03.2023

1

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022, kao i Odlukom br. 767 od 03.03.2023, UD Glavnog Izvršnog Direktora NPK „Trafiku Urban" SH.A., Priština, objavljuje:

## J A V N I K O N K U R S

**Radno mesto**: Mehaničar
**Broj pozicija**: 4 (četiri)
**Trajanje**: 1 godina sa mogućnošću produženja
**Probni period**: 3 meseca
**Nivo plate**: XV
**Dužnosti i odgovornosti**:
• Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.
**Kvalifikacije i veštine:**
• Stručno obrazovanje iz oblasti mehanike
• Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
• Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.
**2. Potrebna dokumentacija:**
• Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
• Dokaz o obrazovanju
• Kopija lične karte;
• Dokaz o radnom iskustvu
• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

**Opšte informacije:**
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

**Način primene:**
Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com.
Konkurs je otvoren od 06.03.2023 i završava se 20.03.2023 do 16:00 časova.

**Napomena:** Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.
Datum: 06.03.2023

2

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.770 të datës 03.03.2023, UD Kryeshefi Ekzekutiv i NPK " Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e Punës: Zyrtar për Marketing**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Kohëzgjatja:** 1 vit me mundësi vazhdimi
**Periudha provuese:** 3 muaj
**Niveli i Pagës**: XIV
**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë Universitare
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Mënyra e Aplikimit:**
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkursi është i hapur nga data 06.03.2023 dhe përfundon më datë 20.03.2023 deri në ora 16:00.
**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 06.03.2023

1

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.770 od 03.03.2023.godine, izvršni direktor UD NPK „Trafiku Urban" SH, Priština, objavljuje:

## JAVNI KONKURS

**Radno mesto**: **Sluzbenik za marketing**
**Broj pozicija**: 1 (jedan)
**Trajanje**: 1 godina sa mogućnošću produženja
**Probni period**: 3 meseca
: XIV
**Dužnosti i odgovornosti:**

- Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.

**Kvalifikacije i veštine:**
• Fakultetska diploma
• 1 godina radnog iskustva;
• Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
• da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;
2. **Potrebna dokumentacija:**
• Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
• Dokaz o obrazovanju;
• Kopija lične karte;
• Dokaz o radnom iskustvu
• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.
**Opšte informacije:**
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.
**Način primene:**
Prijava se može izvršiti samo putem e-pošte: punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkurs je otvoren od 06.03.2023 i završava se 20.03.2023 do 16:00 časova.
Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.
Datum:06.03.2023

2

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.771 të datës 03.03.2023, UD Kryeshefi Ekzekutiv i NPK " Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

## KONKURS I JASHTËM

**Pozita e Punës: Zyrtar për Protokoll**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Kohëzgjatja:** 1 vit me mundësi vazhdimi
**Periudha provuese:** 3 muaj
**Niveli i Pagës:** XVI

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë Universitare apo shkollim i mesëm
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Mënyra e Aplikimit:**
Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkursi është i hapur nga data 06.03.2023 dhe përfundon më datë 20.03.2023 deri në ora 16:00.
**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 06.03.2023

1

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33







TrafikuUrban

U prilog članu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 I 5 I član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima I Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji I sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao I Odlukom br.771 od 03.03.2023.godine, Izvršni irector UD NPK „Trafiku Urban" SH, Priština, objavljuje:

## JAVNI KONKURS

Radno mesto: **Službenik za protokol**
Broj pozicija: 1 (jedan)
Trajanje: 1 godina sa mogućnošću produženja
Probni period: 3 meseca
Nivo plate: XVI

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.

**Kvalifikacije i veštine:**
• Univerzitetska ili srednja stručna sprema
• 1 godina radnog iskustva;
• Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
• da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;
**2. Potrebna dokumentacija:**
• Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU https://vvv.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune;
• Dokaz o obrazovanju;
• Kopija lične karte;
• Dokaz o radnom iskustvu
• Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
• Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;
-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.
**Opšte informacije:**
- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promoviše angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.
- Pismeni test i intervju biće obavljeni nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.
**Način primene:**
Prijava se može izvršiti samo putem e-pošte: punesimi@trafikurban-pr.com,
Konkurs je otvoren od 06.03.2023 i završava se 20.03.2023 do 16:00 časova.
**Napomena:** Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.
Datum:06.03.2023

2

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Auto Shkolla "Trimi" në Gjilan, njofton kandidatët e interesuar për regjistrimin e patentë shoferit se për nder të festave të muajit mars bënë zbritje në pagesë.

- "INSIDER" L.L.C shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër të regjistrimit: 71239969

- Skender Shotka shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Senahid Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Jeton Berisha shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Florim Aliaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Vlera Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Shkrije Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Melisa Malaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfm Ulët "Selman Riza" Piskot Gjakovë nga kl. VI-IX.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues